

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Universiteti “Fan S. Noli” Korçë, duhet të publikojë Programin e Transparencës të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale . Në kuadër të këtij programi, Universiteti “Fan S. Noli” duhet të publikojë informacion sipas veprimtarisë së tij funksionale, duke përditësuar Programin e Transparencës në çdo rast të ndryshimit të aktivitetit institucional, kuadrit ligjor rregullator apo çdo elementi tjetër që ka lidhje me transparencën proaktive.

Në Programin e Transparencës janë të specifikuara kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë: i plotë, i saktë, i përditësuar, i thjeshtë në konsultim, i kuptueshëm, lehtësisht i aksesueshëm dhe i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të Universiteti “Fan S. Noli” Korçë. Gjithashtu, përpara publikimit të informacionit Universiteti “Fan S. Noli” duhet të vlerësojë nëse ka ndonjë kufizim ligjor për publikim.

Në programin e transparencës janë të specifikuara kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik, mënyra e publikimit, si dhe parashikimet ligjore prej të cilave lind detyrimi për publikim. Në publikimin e informacionit, Universiteti “Fan S. Noli” Korçë duhet të mbajnë parasysh interesin e publikut si dhe të mundësojnë aksesimin lehtësisht në informacionin publik.